



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 253, datë 11.12.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMET E TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI PËR KOORDINIMIN E ANALIZAVE TË SIGURISË SË OPERIMIT NË PËRPTHJE ME NENIN 75 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN (BE) 2017/1485 TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, nenit 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, nenit 68, të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendim të ERE me Nr. 186, datë 10.11.2017, nenit 19, pika 1, gërma f) dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s“, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sha, është anëtar me të drejta të plota i ENTSO-E, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7997 Prot, datë 20.11.2018 shoqëria “OST” sha, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përkatësisht nenet 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s Nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 68 "Metodologjia për Koordinimin e Analizave të Sigurisë", bashkëngjitur është dërguar për miratim "Propozimet e të

gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike" si dhe dokumentin mbështetës mbi mënyrën e zbatimit të këtij propozimi, të përkthyer në shqip nga "OST" sha, në përputhje me nenin 46 të dokumentit origjinal.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e "Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike".
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftoje palët e interesuara lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohehet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI